

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	17.12	20	21
Nj. Org	nr. mëm	Vlera	
03-432/02-64545			



KOMUNA E GLOGOCIT
DREJTORATI PËR BUXHET DHE FINANCA
Sektori i Tatimit në Pronë

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nenit 9, si dhe në bazë të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon këtë:

PROPOZIMVENDIM

- **Për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2022**

Neni 1

Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Glogocit cakton normat tatimore për vitin 2022 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

- Për njësitet bujqësore të parcelave-----0.15%
- Për njësitet bujqësore të objekteve-----0.15%
- Për njësitet pyjore të parcelave-----0.15%
- Për njësitet rezidenciale të parcelave-----0.15%
- Për njësitet rezidenciale të objekteve-----0.15%
- Për njësitet komerciale të parcelave-----0.16%
- Për njësitet komerciale të objekteve-----0.16%
- Për njësitet industriale të parcelave-----0.20%
- Për njësitet industriale të objekteve-----0.20%

Neni 2

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Tatimit në Pronë.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal dhe do të fillojë së zbatuari nga 1 janari 2021.

Iu dërgohet:

- Komitetit për politikë dhe Financa
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Ministrisë për Financa
- Zyrës të Tatimit në Pronë
- Arkivit komunal

Vendimi Nr.

Datë:



Kryetari i Komunës

Z. Ramiz Lladrovci